

2

Marrja e vendimeve financiare

Shpend Balija

PhD.c

Kapitulli 2 - Permbajtja

- Financa shkence apo art?
- Objektivat e menaxhimit financiar
- Funksionet e menaxhimit financiar
- Format e organizimit
- Tregjet financiare

Cka eshte financa?

- Financa ka te beje me marrjen e vendimeve per te krijuar **vlere** perbrenda firmes.
- Financa ndertohet mbi disiplinën e **ekonomiksit** dhe **kontabilitetit**.
 - ekonomiksi ofron teori ne lidhje me sistemin ekonomik dhe vendimmarrjen,
 - kontabiliteti ofron te dhena dhe instrumente per analiza te metutjeshme.
- Financa ka evoluar nga nje discipline deskriptive ne ate analitike me kalimin e viteve, ku ndihmon menaxhmentin ne vendimmarrje.

Cka eshte financa?

- Disciplina e finances tenton qe te ndihmoje menaxhmentin ne vendimmarrje ne lidhje me keto pika:
 1. Ne cilat investime apo projekte afat-gjata te angazhohet firma? (**vendimi i buxhetimit kapital**)
 2. Si te paguaj firma per asete? Permes ekuitetit apo borxhit? (**vendimi i struktures se kapitalit**)
 3. Sa para te gatshme apo inventar te mbaj firma? sa te perdoret kapitali i firmes? (**vendimi mbi kapitalin punues dhe perdorimin e tij**)
- Keto vendime merren brenda kornizes se **riskut dhe-kthimit**.

Llojet e vendimeve financiare

- 1. Vendimi mbi financimin**
- 2. Vendimi mbi investimin**
- 3. Vendimi mbi dividendin**

Organizimi i firmave

Qka eshte firma apo biznesi?

- Biznesi kuptohet si organizate i cili ekziston qe te veproje ne prodhim, shitje, ose ne furnizim me te mira dhe sherbime
- Biznesi eshte organizate, e cila shfrytezon resurset ekonomike qe te krijoje te mira dhe sherbime, te cilat i blejne konsumatorret
- Biznesi eshte organizate, e cila krijon dhe ofron pune per njerezit
- Biznesi eshte organizate, e cila investon ne resurse me qellim qe te krijoje me shume para per pronaret

Sipas formes se organizimit firmat ndahen ne:

- Firmat individuale
- Ortakëria
- Korporatat

Firmat individuale

Perpresite:

- Lehtesia e fillimit dhe zhvillimit te biznesit
- Pronari eshte shef i vetvetes
- Pronari gezon te drejten ne fitim
- Tatimimi kryesisht i lehte dhe pa tatime te veqanta

Te metat:

- Pergjegjesi e pakufizuar
- Kufizimi i resurseve financiare
- Veshtiresite ne menaxhment
- Kufizimi i rritjes dhe i jetegjatesise

Ortakëria

Perpresite:

- Resurse me te medha financiare
- Aftesi me te larta menaxhuese dhe organizative
- Lehte themelohet, minimum kufizime ligjore
- Tatimet me te uleta nga korporatat

Te metat:

- Bonitet kreditor me i vogel se korporatat
- Mosmarrveshjet mes partnerve jane te mundshme
- Kontinuiteti ne pune
- Veshtiresi per te ardhur te kapitali me i madh

Cka eshte korporata ?

- Korporata eshte forme e shoqerive aksionare, e cila bazohet ne kodin e inkorporimit, i cili percakton qellimet e biznesit, numrin e aksioneve qe mund te emetohen si dhe numrin e drejtoreve qe do te jene pjese e bordit.
- Kapitali i nje korporate formohet permes shitjes se aksioneve. Aksioni eshte nje titull pronesie ndaj nje pjese te pasurise se shoqerise. Pra eshte nje leter me vlere qe verteton se nje individ ka investuar ne shoqeri vleren nominale te aksionit dhe kjo i jep te drejten ne fitim, qe eshte dividenda.
- Aksionaret jane pronare te korporates, mirepo kane pergjegjesi te kufizuar. Mbajtesit e aksioneve mund ti shesin ate ne dy menyra: me oferte publike dhe pa oferte publike

Korporata

Perpresite:

- Menaxhim me efikas
- Pergjegjesia e kufizuar
- Madhesia e korporatave, qasje me e lehte ne burime financiare
- Lehtesi per transferin e pasurise

Te metat:

- Tatimimi i dyfishte
- Kostoja fillestare
- Jofleksibiliteti
- Konflikti i mundshem

Format e organizimit

	Individuale	Ortakëri	Korporata
Kush është pronar i biznesit?	Menaxheri	Partnerët	Aksionarët
A janë menaxherët e ndarë nga pronarët?	Jo	Jo	Zakonisht
Çfarë është përgjegjësia e pronarit?	Pa-kufizuar	Pa-kufizuar	Kufizuar
A paguhet tatimi dy herë (nga pronarët si dhe nga biznesi?)	Jo	Jo	Po

Strategjia financiare e firmes

Ne formulimin e strategjise financiare ndikojne keta faktore:

- a. Faktoret e rrethines**
- b. Grupet e interesit**
- c. Objektivat ekonomike**
- d. Pergjegjesia sociale**


Objektivat e menaxhimit financiar

- Qellimi primar i firmes eshte maksimizimi i pasurise se aksionareve. (sepse firma eshte prone e aksionareve).
- Ky qellim matet permes cmimit te aksioneve ne treg, qe do te tregon cmimin te cilin investitoret jane te gatshem qe te paguajn ne menyre kolektive.
- Ndersa profiti eshte dicka dytesore sepse ka me teper veshtirese ne matjen e tij, si dhe mund te ndodhin manipulime sa per te reflektuar gjendje pozitive (fitim apo humbje) nga kontabilistet.


Objektivat e menaxhimit financiar

- Qellimi i maksimizimit të pasurisë së aksionareve mund të bëjë ndesh (konflikt) me interesat e menaxhmentit (kompensimin e tyre)
Teoria e agjencisë ka të bëjë me këtë konflikt mes të menaxhmentit dhe aksionareve.
- Deri sa aksionaret kërkojnë dividendë, menaxhmenti ka interes që të investoj fondet në firmë në mënyrë që të ketë fitim sa më të lartë.

Struktura organizative e korporatave



Detyrat e menaxhereve financiar



Risku-dhe-Kthimi

↑ Profitabiliteti → ↑ Risku

↓ Profitabiliteti → ↓ Risku

- **Menaxheret financiar duhet te marrin vendime te veshtira ne lidhje me potencialin e fitimit dhe riskut. Vendime keto te cilat shpesh here kane efekte definitive.**

Roli i tregjeve financiare

- Tregjet financiare jane nje network i gjere I korporatave, institucioneve financiare, qeverive dhe indiviteve te cilet kane nevoje per fonde apo kane para qe deshirojne ti investojne ato.
- Per te marr pjese ne tregjet financiare firma duhet te regjistrohet si korporate.

Letrat me vlere ne tregjet financiare

Aksionet = ekuitet i pronarit

- **Aksionaret jane pronaret e firmes**
 - Aksione te zakonshme(me drejt vote)
 - Aksione te preferuara (pa drejt vote, dividend fikse)

Bono = obligacione apo borxhe

- **Poseduesit e bonove jane persona te cilet kane japur mjetet e tyre ne kembim te nje interesi monetar.**

Sfidat e menaxhmentit financiar

Ne shekullin 21 sfidat kryesore te zhvillimit te menaxhmentit financiar jane:

❑ **Globalizimi i ekonomise: Ilogaritet se do te ndikojne keta faktore:**

- Permirosimi i transportit dhe komunikimit do te ndikojne ne uljen e shpenzimeve dhe do te beje tregtine nderkombetare me te realizueshme
- Ngritja e ndikimit politik te konsumatoreve do te ndikojne ne zvoglimin e barrierave tregtare
- Presioni i konkurrences do t'i shtyje firmat t'a shperngulin prodhimin ne vendet ku kane shpenzime me te uleta.

❑ **Aplikimi i teknologjise informative do te ndikojne qe:**

- Bizneset t'i zvoglojne shpenzimet dhe t'i zgjerojne tregjet
- Ndersa ndryshimi ne teknologji ndikon ne shtimin e konkurrences, e cila shprehet ne renie te fitimit ne tregjet e zgjeruara